



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Akreditimit Institucional Periodik i Kolegjit
Profesional të Tiranës**

Shtator 2022

GRUPI I VLERËSIMIT:

1. Prof. Ana Kapaj Kryetar
2. Assoc.Prof. Besnik Krasniqi Anëtar

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi Error! Bookmark not defined.

Konteksti i këtij vlerësimi Error! Bookmark not defined.

Niveli i përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në akreditimin e fundit Error!
Bookmark not defined.

Përmbledhje e Raportit..... Error! Bookmark not defined.

Praktika e mirë..... Error! Bookmark not defined.

Pikat e dobëta..... Error! Bookmark not defined.

Rekomandime..... Error! Bookmark not defined.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra Error! Bookmark not defined.

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi Error! Bookmark not defined.

Gjykim i përmbledhur Error! Bookmark not defined.

Fusha e vlerësimit 1: Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i CilësisëError! Bookmark not defined.

Gjetje..... Error! Bookmark not defined.

Praktika e mirë..... Error! Bookmark not defined.

Pikat e dobëta..... Error! Bookmark not defined.

Rekomandime..... Error! Bookmark not defined.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra Error! Bookmark not defined.

Gjykimi Error! Bookmark not defined.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet dhe Partneriteti Error! Bookmark not defined.

Gjetje..... Error! Bookmark not defined.

Praktika e mirë..... Error! Bookmark not defined.

Pikat e dobëta..... Error! Bookmark not defined.

Rekomandime..... Error! Bookmark not defined.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra Error! Bookmark not defined.

Gjykimi Error! Bookmark not defined.

Fusha e vlerësimit 3: Programet e studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi Error!
Bookmark not defined.

Gjetje..... Error! Bookmark not defined.

Praktika e mirë..... Error! Bookmark not defined.

Pikat e dobëta..... Error! Bookmark not defined.

Rekomandime..... Error! Bookmark not defined.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra Error! Bookmark not defined.

Gjykimi Error! Bookmark not defined.

Fusha e vlerësimit 4: Veprimtaria Shkencore/Artistike dhe InovacioniError! Bookmark not defined.

Gjetje..... Error! Bookmark not defined.

Praktika e mirë..... Error! Bookmark not defined.

Pikat e dobëta..... Error! Bookmark not defined.

Rekomandime..... Error! Bookmark not defined.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra Error! Bookmark not defined.

Gjykimi Error! Bookmark not defined.

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre Error! Bookmark not defined.

Gjetje..... Error! Bookmark not defined.

Praktika e mirë..... Error! Bookmark not defined.

Pikat e dobëta..... Error! Bookmark not defined.

Rekomandime..... Error! Bookmark not defined.

Ekipi i Vlerësimit nuk dha asnjë rekomandim..... Error! Bookmark not defined.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra	Error! Bookmark not defined.
Gjykimi	Error! Bookmark not defined.
Lista e evidencave	Error! Bookmark not defined.

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë mase institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë (Kodi i Cilësisë) në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2021. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë të vlerësimit të arsimit të lartë, të caktuar nga ASCAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga vlerësues me përvojë në arsimin e lartë në Shqipëri dhe në Kosovë.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional periodik, që bazohet te shkalla e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'u ofruar informacion IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve për mënyrën se si i përmbushin IAL-të standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i Cilësisë; Burimet dhe Partneriteti; Programet e Studimit, Mësimdhënia, dhe Vlerësimi; Aktivitetet Shkencore/Artistike dhe Novacioni; Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykitit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Bordit të Akreditimit të ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përpilimit të raportit, ASCAL-i ka siguruar këshillim dhe asistencë eksperte për grupin e vlerësimit të jashtëm duke siguruar që gjetjet e raportit të mbështeten në evidenca, si dhe me korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) është një institucion privat i arsimit të lartë në vend, nën pronësinë e shoqërisë KPT shpk. Është licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 699, datë 26.08.2015, si institucion privat i arsimit të lartë, me statusin e Kolegjit profesional, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 154, datë 02.09.2015. Kolegji Profesional i Tiranës ka marrë lejen për të filluar veprimtarinë e tij me shkresë me numër protokolli 9113, datë 06.11.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Urdhër Nr. 426, datë 06.11.2015 “Për lejimin dhe ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë institucionit privat të arsimit të lartë, Kolegjit Profesional të Tiranës”.

KPT-ja e ushtron veprimtarinë e saj sipas sistemit të Bolonjës dhe përkon me Nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në zbatim të Ligjit Nr. 10 247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar, dhe për afron Nivelin 5 të Sistemit të Bolonjës. Kolegji ka dy departamente që ofrojnë diploma profesionale pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë.

Të gjitha programet e studimit në KPT zgjasin 2 vjet dhe kanë 120 kredite. Në vijim gjeni diplomat përkatëse sipas departamenteve.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit:

“Teknologji Informacioni dhe Komunikim”, “Elektronikë”, “Database dhe Web Design”, “Teknologji e Instalimeve Elektrike”, dhe “Administrim Zyre”,

Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara:

“Elektromekanikë”, “Teknologji Automjetesh”, “Mekatronikë”, “Teknologji Ventilimi dhe Ajri të Kondicionuar”, “Gjeodezi”, “Teknologji Ndërtimi”, dhe “Teknologji Gazi”.

Akreditimi i parë institucional u zhvillua në vitin 2017, me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 66, datë 21.09.2017 “Për akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës””.

Niveli i përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në akreditimin e fundit

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr., datë., janë:

1. Institucioni duhet të artikulojë dhe të zbatojë një plan të qartë për të pasuruar bibliotekën dhe për të ofruar tekste fizike dhe literaturë të mjaftueshme online për të gjithë studentët deri në vitin 2018.
2. Institucioni duhet t'iu ofrojë studentëve me aftësi të kufizuara akses të plotë në çdo hapësirë të kampusit.
3. Institucioni parashikon burimet financiare për Këshillin Studentor.

II. Përmbushja e rekomandimeve nga institucioni

1. Në vijim të rekomandimeve dhe krahasuar me periudhën e akreditimit të parë, KPT-ja ka pasuruar fondin e bibliotekës me 50 tituj në lidhje me procesin mësimor. Krahas kësaj, studentët dhe stafi kanë akses në bibliotekën online. KPT-ja ka lidhur një marrëveshje me Universitetin Evropian të Tiranës për të përdorur bibliotekën e këtij të fundit.
2. KPT-ja i kryen veprimtaritë arsimore në katin e parë të godinës. Gjatë rinovimeve që u bënë në godinë, u morën masa për ta bërë katin e parë të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara. Veç kësaj, në katin e parë të godinës ndodhet një tualet i dedikuar për këtë grup social.
3. Në lidhje me mbështetjen financiare të Këshillit Studentor, KPT-ja nuk alokon një fond specifik. KPT-ja ofron mbështetje financiare për veprimtari të ndryshme që kryhen nga Këshilli gjatë vitit akademik. Këto veprimtari planifikohen paraprakisht dhe më pas zyra e financës pranë KPT-së bën rimbursimet dhe pagesat sipas rastit.

Përmbledhje e Raportit

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Infrastruktura dhe veçanërisht laboratorit dhe pajisjet e KPT-së janë të përditësuara dhe mundësojnë praktikë të mirë për studentët dhe stafin akademik. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.12]**
- Bashkëpunimi i ngushtë me partnerët dhe bizneset krijon një perspektivë pozitive për punësimin e studentëve të KPT-së në të ardhmen **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.19]**
- Në veçanti, Laboratori i Inovacionit dhe stafi i ri janë shembuj të mirë. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.20]**
- Stazhet në vende të tjera. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.14]**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Numri i ulët i stafit të brendshëm në kategorinë Profesor. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.1]**

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Kryerja e studimit të tregut për programe të reja studimi, dhe analizimi i programeve ekzistuese dhe vlerësimi i potencialit të tregut për secilin prej tyre. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.22]**
- Rritja e numrit të stafit akademik në kategorinë Profesor. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.1]**
- Ofrimi i shërbimeve për palë të treta, që rritin të ardhurat e institucionit. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.16, II.17, II.18]**
- Puna për projekte specifike me sektorin privat që përfshin kërkime të aplikuara. KPT-ja duhet të synojë rritjen e të ardhurave për aktivitetet kërkimore dhe portofolin e shërbimeve të stafit të saj. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.17]**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- KPT-ja ka rritur bashkëpunimin ndërkombëtar përmes projekteve dhe marrëveshjeve të ndryshme me universitete dhe biznese. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.20, II.21].**

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Menaxhimin, Autonominë dhe Sigurimin e Cilësisë janë **përbushur plotësisht.**
2. Standardet për Burimet dhe Partneritetin janë **përbushur kryesisht**
3. Standardet për Programet e Studimit, Mësimdhënien dhe Vlerësimin janë **përbushur plotësisht.**
4. Standardet për Veprimtarinë Shkencore/Artistike dhe Inovacionin janë **përbushur kryesisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**

Gjykim i përmbledhur

Vlerësuesit e jashtëm i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se në Kolegjin Profesional të Tiranës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e vlerësimit 1: Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i Cilësisë

- 1.1 Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) e kryen veprimtarinë akademike dhe profesionale mbështetur tek aktet ligjore në fuqi, te Statutit i saj, si dhe tek akte të tjera rregullatore të brendshme të miratuara nga organet dhe autoritetet e saj drejtuese. KPT-ja është institucion privat dhe e filloi veprimtarinë e saj në vitin 2015. Statuti përcakton misionin e universitetit, dhe strukturat e organizimit dhe menaxhimit të brendshëm. Përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit dhe këshillit janë përcaktuar gjithashtu në rregullore. Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik kanë miratuar Statutin për të marrë parasysh Ligjin për Arsimin e lartë, që është konfirmuar edhe nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë. **(A2, A4, A5, BM2) [Shtojca Nr. 1, Standardi I.1]**
- 1.2 KPT-ja është organizuar për të siguruar menaxhim të efektshëm në përputhje me kërkesat ligjore dhe Planin e saj Strategjik. **(BM2)** Rrjedha e informacionit nga njësitë bazë te Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik, dhe shpërndarja e vendimeve nga organet drejtuese te stafi dhe studentët, janë efikase. **(BM4, BM6)** Organizimi i menaxhimit dhe administrimit të institucionit, dhe vendimmarrjes kolegjiale, kanë parasysh kërkesat ligjore, zbatohen dhe kuptohen nga stafi në të gjitha nivelet. **(A2, A4, A5) [Shtojca Nr. 1, Standardi I.2]**
- 1.3 KPT-ja ka një strategji zhvillimi të përshtatshme. Ajo funksionon bazuar te një strategji zhvillimi 5-vjeçare. Strategjia e parë u zbatua në periudhën 2015 - 2020 dhe theksonte zgjerimin horizontal dhe vertikal të KPT-së. Së fundi, KPT-ja ka hartuar një dokument të ri zhvillimi, me titull Strategjia 2021 - 2025 **(A5)**. Strategjia është përpiluar në përputhje me Misionin dhe objektivat e KPT-së, dhe u mor në konsideratë nga organet drejtuese dhe këshillat në faza të ndryshme gjatë hartimit të saj. **(BM2)** Departamentet, si njësi bazë, kanë hartuar dhe zbatuar plane veprimi për të përmbushur kërkesat e Strategjisë. **(BM8)** Strategjia e zhvillimit të Kolegjit Profesional të Tiranës shihet në kontekstin e mjedisit ku operon tregu i punës, ku arsimi profesional është zgjidhje optimale përmes kompetencave të përvetësuarra profesionale. **(A5) [Shtojca Nr. 1, Standardi I.3]**
- 1.4 KPT-ja siguron që të funksionojë brenda kufizimeve të legjislacionit dhe rregulloreve ekzistuese. Si një institucion privat, vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë e mësimdhënies dhe ato praktike, dhe çështjet financiare dhe administrative. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan një rol kyç në monitorimin dhe analizimin e efikasitetit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është projektuar për të zhvilluar dhe zbatuar një mekanizëm, që inkurajon promovimin dhe përvetësimin e një kulture cilësie në të gjitha njësitë dhe nivelet, dhe për të zhvilluar procedura të përshtatshme për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë akademike. **(BM2, BM8, A8) [Shtojca Nr. 1, Standardi I.4]**
- 1.5 Organet drejtuese mbledhen rregullisht dhe informacioni për pikat e agjendës i vihet paraprakisht në dispozicion të gjithë stafit. Marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, dhe për të mbështetur diskutimet dhe debatet kolegjiale kuptohen nga stafi dhe studentët. Përgjegjësit e departamenteve kanë detyrë të kryejnë monitorimin vendor të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e krijuar formalisht. **(BM4, BM6, A13) [Shtojca Nr. 1, Standardi I.5]**

- 1.6 Raporti vjetor për Ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë ofron shpjegime për programet e mësimdhënies dhe studimit, formimin profesional, stafin, veprimtarinë e projektit dhe çështjet ekonomike dhe financiare. Procesi i hartimit është informuar nëpërmjet raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe vetëvlerësimit nga çdo departament. **(BM8)** Raporti përfundimtar miratohet nga Senati Akademik. Pasi miratohet nga strukturat dhe organet përkatëse të institucionit, i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botohet në faqen zyrtare të KPT-së **(A16)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi I.6]**
- 1.7 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë e rëndësishme dhe e përhershme e KPT-së. Ajo ka akses të të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi përbëhet nga pedagogë që përfaqësojnë Departamentet e KPT-së, një përfaqësues nga njësitë ndihmëse, një anëtar - ekspert i jashtëm, dhe një përfaqësues i studentëve. **(BM8)** Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një element të cilit KPT-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë. KPT-ja harton politika dhe ngre strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe krijon kushtet për kryerjen e veprimtarisë së vlerësimit dhe sigurimit të jashtëm të cilësisë. **(A2, A8)** **[Shtojca Nr. 1, Standardi I.7]**
- 1.8 KPT-ja vlerëson periodikisht programet e studimit për të monitoruar arritjen e objektivave dhe rezultateve të të nxënit. Njësitë bazë, në bashkëpunim me anëtarët e departamenteve, rishikojnë programet e studimit dhe syllabuset përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, aktet rregullatore të KPT-së, dinamikat teknologjike, duke përfshirë vlerësimin e punësimit të studentëve si një nga treguesit matës të performancës së programeve. Në këtë kontekst, njësia bazë propozon ndryshime ndaj portofolit akademik të KPT-së, duke e orientuar atë drejt programeve cilësore të kërkuara nga tregu i punës. Krahas kësaj, KPT-ja përfshin ekspertë të jashtëm në vlerësimin e aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së saj, si: kurrikula/programet e studimit, etj. **(A19, A75)** **[Shtojca Nr. 1, Standardi I.8]**
- 1.9 Sikundër përmendet në Standardin 1.7, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është zyrë e përhershme në KPT **(A2, A8)**. Ajo ka akses të të gjitha të dhënat e institucionit. Në fillim të çdo viti, NJSBC-ja miraton një plan pune për mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademike dhe administrative të KPT-së. Që prej ngritjes së saj, NJSBC-ja ka kontribuar për përmirësimin e të gjitha aspekteve të procesit mësimor, qoftë sa i përket përmirësimit të kurrikulave dhe syllabuseve, po ashtu dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohen në të gjitha njësitë e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive në të ardhmen. **(A14)** KPT-ja dhe NJSBC-ja përdorin metoda vlerësimi të tërthorta, si: anketa dhe intervista me studentët dhe të diplomuarit **(A22, A23, A24, A25)** **[Shtojca Nr. 1, Standardi I.9]**
- 1.10 Sipas KPT-së, përgjegjësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë u përket strukturave organizative të KPT-së, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - NJSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të institucionit, të ushtruara në KPT, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Gjatë vizitës në institucion, përfshirja e stafit dhe studentëve në të gjitha veprimtaritë që kishin të bënin me

vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit ishte e dukshme. Kryesisht, kjo është realizuar nëpërmjet sondazheve të kryera nga NJSBC-ja, por edhe nëpërmjet diskutimeve në departamente dhe me studentët. Edhe përfshirja e partnerëve është hap shumë i rëndësishëm i këtij procesi. Gjatë takimit të zhvilluar me partnerët, ata shprehën qartë se mbajnë kontakte të vazhdueshme me KPT-në për hartimin e kurrikulave dhe për ndryshimet e mundshme në kuadër të një përshtatjeje më të mirë me tregun e punës. **(A27, A28) (BM6) [Shtojca Nr. 1, Standardi I.10]**

1.11 Të gjitha veprimtaritë në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit janë publike, transparente dhe të efektshme. Objektivi kryesor është krijimi i Kulturës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me kalimin e viteve. Ndryshimet në strukturën e NJSBC-së i njoftohen stafit përkatësisht. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohen në të gjitha njësitë e institucionit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtyre veprimtarive në të ardhmen dhe marrjen e masave të përshtatshme për mangësitë e identifikuar gjatë vlerësimit. **(A14, A30) [Shtojca Nr. 1, Standardi I.11]**

Gjetje

Praktika e mirë

Ekipi i Vlerësimit nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë.

Pikat e dobëta

Ekipi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Ekipi i Vlerësimit nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Ekipi i Vlerësimit nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Menaxhimin, Autonominë dhe Sigurimin e Cilësisë janë përmbushur plotësisht

Fusha e vlerësimit 2: Burimet dhe Partneriteti

2.1 KPT-ja ka hartuar politika efektive për rekrutimin e stafit. Struktura organizative diskutohet dhe miratohet nga Senati Akademik dhe nga Bordi i Administrimit. Në faqen e internetit ka një rubrikë për rekrutimin, ku kandidatët mund të ngarkojnë CV-në dhe të shprehin interesin e tyre. (<https://kolegjiprofesional.edu.al/>) Në strukturën e përgjithshme të miratuar paraqiten hollësisht rolet e stafit akademik dhe administrativ. **(A2, A4, A31)** Rekrutimi në njësitë akademike mbështetet nga nevojat për çdo departament, programi i studimit dhe kurrikulat, dhe nëse roli është me kohë të plotë apo të pjesshme. Vendet vakante publikohen në portalin online. Procesi i rekrutimit për stafin akademik dhe administrativ ndjek të njëjtin proces të përcaktuar në Statut dhe në Rregullore, që marrin në konsideratë legjislacionin përkatës. Nevojat për staf të ri administrativ merren parasysh nga Administratori në shtator. Për vlerësimin e aplikimeve të kandidatëve ngrihet një komision, që kryen vlerësim në bazë të meritave individuale dhe kontrata e punësimit nënshkruhet nga Rektori. Gjatë procesit të rekrutimit, duke nisur nga thirrja, KPT-ja ndjek një proces rekrutimi të paanshëm, mbështetur në aftësitë, përshtatshmërinë e kandidatit për pozicionin dhe, mbi të gjitha, meritokracinë. Treguesit e performancës së kandidatëve janë kriteri kryesor ku bazohet vlerësimi i rekrutimit të kandidaturave. Ata përfshijnë cilësinë dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke u dhënë përparësi universiteteve përëndimore, ose kualifikimeve në këto universitete. Në lidhje me kualifikimet dhe titujt akademikë të stafit akademik, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon KPT-së që të rritë numrin e stafit akademik në kategorinë Profesor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron pikë të dobët të KPT-së. **(A31, A43) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.1]**

2.2 KPT-ja është e angazhuar ndaj zbatimit të politikave të integritetit të stafit akademik dhe administrativ, që përcaktohen *Strategjinë e Zhvillimit 2021-2025*. I gjithë stafi akademik është pjesë e procesit të vlerësimit **(BM3, BM4, BM6)**. Stafi akademik merr pjesë në një sërë veprimtarish, si workshop-e, aktivitete në terren dhe organizime sociale, krahas mësimdhënies dhe punës praktike. Në bashkëpunim me studentët, stafi akademik merr pjesë në veprimtari jashtëkurrikulare dhe aktivitete sociale. KPT-ja ndjek një politikë me qasje integruese ndaj stafit, që konsiderohet si një aset kyç i suksesit të KPT-së. Në praktikë, kjo qasje mundësohet nëpërmjet organizimit të veprimtarive të përbashkëta të stafit akademik dhe atij administrativ, si: pjesëmarrja e përbashkët në trajnime stafi, workshop-e, vizita studimore, aktivitete, veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si: Trajnimi i përbashkët i stafit në projektin MoVet në Dolo, Venecia, Itali, Workshop-i Design Thinking në Tiranë, ku morën pjesë pedagogët dhe stafi administrativ, vizita studimore në Gent, Belgjikë në kuadër të projektit Engine, ku morën pjesë anëtarët e stafit të administratës, pjesëmarrje në ture dhe panairë, si: Panairi i Punës dhe Studimit, etj. **(A35, BM3, BM4, BM6) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.2]**

2.3 Objektivat strategjikë të zhvillimit të stafit përcaktohen në *Strategjinë e Zhvillimit* dhe KPT-ja ndjek një politikë të trajnimit në vazhdimësi të stafit në përputhje me këta objektiva. **(A5)** Stafit akademik i ofrohet mbështetje për pjesëmarrje në veprimtari formuese në institucione të tjera të ngjashme dhe ndërkombëtare. Aftësitë e stafit vlerësohet në forma të ndryshme, nga eprori i drejtpërdrejtë/përgjegjësi i Departamentit, studentët, zyra e burimeve njerëzore, dhe NJSBC-ja **(A2, A31)**. Gjatë vitit akademik, Pedagogu vlerësohet drejtpërdrejt nga eprori. Ai mund të kryhet në formën e kontrolleve periodike gjatë procesit mësimor, si dhe në formën e shqyrtimit të raporteve të punës kundrejt syllabuseve **(BM3, BM4, BM6, A14)**. Opinioni dhe vlerësimi nga

studentët konsiderohen si aspekte shumë të rëndësishme. Ky vlerësim shprehet nëpërmjet formularëve të përgatitur në kuadër të vlerësimit të performancës, kryesisht si sondazhe. **(A22, BM3).** [Shtojca Nr. 1, Standardi II.3]

2.4 KPT-ja ka organizuar një sërë aktivitetesh për të nxitur dialogun social ndërmjet stafit, studentëve dhe komunitetit të përgjithshëm. Shembujt përfshijnë veprimtaritë sociale, fushatë javore të ndërgjegjësimit, si dhe ditët e hapura për studentët e mundshëm. Stafi akademik është përfshirë në konferenca dhe workshop-e të ndryshme, ndërsa studentët janë angazhuar me institucione vendase në projekte të ndryshme. Zyra e Burimeve Njerëzore planifikon veprimtari të ndryshme sociale në kuadër të festave, si: festa e fundvitit, festat e 7-8 marsit, përvjetorët, ditëlindjet e stafit të KPT-së, etj., që shërbejnë si një mënyrë për të bashkuar, për të afruar dhe për të motivuar stafin. Në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, Mbështetjes dhe Informacionit, organizohen aktivitete sociale, si: mbledhja e dhuratave për bamirësi, dhurimi i gjakut, promovimi i librave të anëtarëve të stafit, etj. **(A33, A40)** [Shtojca Nr. 1, Standardi II.4]

2.5 KPT-ja ka 2 departamente që janë organizuar në përputhje me kërkesat ligjore. **(BM2, BM8)** Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. Megjithatë, ndonëse strukturat janë të veçuara nga njëra-tjetra, për shkak të numrit të vogël të stafit akademik dhe administrativ, ndonjëherë mbivendosen detyrat. **(BM, BM5, BM6, BM7)** Kolegji Profesional i Tiranës, gjatë periudhës midis dy akreditimeve, ka mundësuar qëndrueshmërinë e stafit të brendshëm akademik dhe administratës, duke e konsideruar si faktor kyç të suksesit afatgjatë. Një nga kriteret kryesore të përzgjedhjes së stafit është shpërndarja e stafit akademik sipas përvojës së tij dhe nevojës së departamenteve. Niveli i ndryshueshmërisë së stafit të brendshëm akademik dhe administratës nga akreditimi i fundit deri në momentin e raportimit vlerësohet të jetë nën 1%. Përzgjedhja e stafit të brendshëm dhe të jashtëm bëhet duke marrë parasysh fushat e përgjithshme dhe specifike të studimit të stafit akademik, që angazhohet në çdo departament **(A43).** [Shtojca Nr. 1, Standardi II.5]

2.6 Vlerësimi i aftësive të stafit kryhet në mënyra të ndryshme. Kryhet nga eprori i drejtpërdrejtë, përgjegjësi i departamentit ose përgjegjësi i zyrës. Gjithashtu edhe nga studentët, nga zyra e burimeve njerëzore, dhe NJSBC-ja. NJSBC-ja kryen një vlerësim të vazhdueshëm të ecurisë së të nxënit, mbikëqyrje për kontrollin e provimeve, përputhshmërinë e mësimdhënies me përmbajtjen e përcaktuar të kursit dhe mundësimin e materialeve shtesë, si literatura ose leksionet. KPT-ja i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes dhe transparencës, duke organizuar mbledhje në nivel departamenti, në rektorat, anketa stafi rreth çështjeve të ndryshme për diskutim, identifikim problemesh, nevojash, marrje të opinionit të stafit për akte të ndryshme rregullatore, etj. **(A2, A31, A26)** [Shtojca Nr. 1, Standardi II.6]

2.7 KPT-ja e ushtron veprimtarinë në adresën: Rruga "Xhanfize Keko", kompleksi "Xhura", me numër prone 5/200, Tiranë. Godina është e marrë me qira, bazuar në Kontratën e Qirasë Nr. Rep. 3758, Nr. Col. 1044, datë 29/09/2015, e ndryshuar. Ambientet janë lehtësisht të aksesueshme me transport publik dhe ndodhen larg qendrave industriale. Godinat janë të izoluara siç duhet dhe me furnizim të rregullt elektriciteti dhe uji, me sisteme ajri të kondicionuar Daikin, të izoluara ndaj zhurmës dhe të pajisura me shkallë dhe dalje emergjence. Ambientet e disponueshme përmbushin kërkesat ligjore dhe ofrojnë kushte të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin e një procesi akademik dhe mjedisi pune të këndshëm. Gjatë vizitës, pamë klasat, zyrat dhe të gjitha

ambientet që ofron KPT-ja. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi që mjediset ishin në kushte të mira. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.7]**

2.8 KPT-ja ka marrë me qira katin e parë (katin përdhes) dhe katin e fundit (katin e katërt) në godinën e referuar si Godina Nr. 2 në planimetrinë bashkëngjitur me Kontratën e Qirasë. Hapësira përdoret për klasa, laboratorë dhe zyra. Një hapësirë prej 280 m² ndodhet në Godinën 1C (kati përdhes), sikundër përshkruhet në Kontratën e Qirasë. Hapësira përdoret për laboratorë/workshop-e. Hapësirat e disponueshme janë në përputhje me normat e lejuara, duke mundësuar 5 m² për student. Sa i përket hapësirave akademike, ato kanë lartë, ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm. Çdo kat është 4 metra i lartë. Ambientet janë lehtësisht të aksesueshme me transport publik dhe ndodhen larg qendrave industriale. Godinat janë të izoluara siç duhet dhe me furnizim të rregullt elektriciteti dhe uji, me sisteme ajri të kondicionuar Daikin, të izoluara ndaj zhurmës dhe të pajisura me shkallë dhe dalje emergjence. **(A21) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.8]**

2.9 Sikundër përmendet në standardet e mësipërme (II.8 and II.9), KPT-ja ka marrë me qira godinën ku ushtron veprimtarinë e saj. Gjatë vitit 2020, godinat i janë nënshtruar një procesi përmirësimi në lidhje me tarracat, fasadat, dhe zonat përreth. Institucioni ofron kushte të mira pune, të sigurta për stafin akademik dhe studentët. Gjithashtu, laboratorët dhe sallat e leksionit/ushtimeve janë të pajisura me pajisjet e nevojshme për procesin mësimor, si laptopë, kompjuterë, projektor dhe akses në internet nëpërmjet Wifi-t. KPT-ja ofron ambiente dhe për stafin akademik, për stafin administrativ, dhe salla mbledhjesh, salla kompjuterike, multimedia, etj. **(A21, A52, A45) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.9]**

2.10 KPT-ja ofron vetëm 2 vite arsimit të lartë profesional, me 120 kredite. Për pjesën praktike të çdo moduli, laboratorët dhe mjediset e zyrave janë të pajisur me rregullat përkatëse të sigurisë teknike, që përbëjnë një element të rëndësishëm të orëve të para të mësimimit në KPT. Secili ambient laboratorik ka manualin përkatës, që i vendoset në dispozicion stafit akademik. **(A46) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.10]**

2.11 Godinat e KPT-së ndodhen brenda një kompleksi dhe rrethohen nga hapësira/kopshte të gjelbra të vogla, të pajisura me stola dhe kosha mbeturinash. Zona përfshin hapësirën e parkimit, zonën rekreative (kopshte të vogla), një kafene, dhe një fushë futbollit. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.11]**

2.12 Klasat dhe laboratorët ofrojnë mundësi të shkëlqyera për të krijuar, për të ndërtuar ose për të simuluar punë laboratorike. Këta laboratorë janë në përdorim të vazhdueshëm nga stafi akademik dhe studentët. Aty ata kryejnë veprimtarinë laboratorike, punojnë me detyrat e caktuara nga pedagogët, si dhe zhvillojnë punë që mund t'u shërbejnë në praktikën e tyre të pavarur. KPT-ja i kushton vëmendje të konsiderueshme zhvillimit të praktikave laboratorike. Secili laborator ka të përcaktuara rregullat përkatëse të sigurisë teknike, që janë element thelbësor për orët e para të mësimdhënies në KPT. Klasat janë të pajisura me mjete audio-vizuale, si: tabela inteligjente, kompjuterë, projektorë, dhe bokse. Të gjitha zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë pajisur me kompjuterë dhe akses tek infrastruktura mbështetëse, si printerët, fotokopjet dhe/ose skanerët. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.12]**

- 2.13 KPT-ja ka një trashëgimi të fuqishme akademike dhe kulturore dhe arkivon botimet e stafit akademik dhe tezat e diplomës të hartuara nga studentët. Ka koordinuar me efektshmëri sistemet e menaxhimit për të siguruar kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit, që përfshijnë dhe të dhënat e studentëve të mbajtura nga Sekretaria Mësimore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se ambientet e ruajtjes dhe arkivimit në biblioteka dhe formë elektronike përmbushin pritshmëritë. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.13]**
- 2.14 KPT-ja ka një sistem të koordinuar të menaxhimit të informacionit. Stafi dhe studentët mund ta aksesojnë nëpërmjet faqes zyrtare të KPT-së, Classter. (<https://identity.classter.com/>) Aplikacionet në nivel institucioni gjenden në Classter dhe përfshijnë të gjitha modulet e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Studentëve (Sistemi). Sistemi mundësohet sipas Kontratës përkatëse me shoqërinë Tech360, që është përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aplikacioneve Classter. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit, si: mësimdhënie, oraret e sezonit të provimeve, rezultatet dhe mbledhjet e punës. Classter përmban shumë informacione, si: karta e studentit, portali pedagogjik, orari mësimor, menaxhimi i librave në format elektronik dhe të shtypur, menaxhimi i pagesave të studentëve, integrimi me emailt e stafit/studentëve, si dhe materiale akademike. Classter mundëson gjenerimin e raporteve të ndryshme që kërkohen nga sekretaria mësimore dhe zyra e financës. Zyra e Financës përdor edhe sisteme të veçanta në lidhje me kontabilitetin, në përputhje me dispozitat ligjore, veçanërisht ato që lidhen me fiskalizimin, që mundësojnë gjenerimin e raporteve sipas nevojës. Gjatë takimeve me studentët, stafin dhe stafin mbështetës u diskutua edhe ndihma që këto sisteme u ofrojnë atyre. **(BM3, BM4, BM5, A64, A64/1, <https://kolegji profesional.edu.al/>) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.14]**
- 2.15 KPT-ja ka ndërmarrë zhvillimin e infrastrukturës së saj digjitale në mbështetje të të nxënësve të studentëve dhe zhvillimit profesional të stafit akademik. Si rrjedhojë, shumica e veprimtarive institucionale janë të disponueshme në formë elektronike në sistemin bibliotekar dhe në një platformë të të nxënësve elektronik, të krijuara për të lehtësuar të nxënësve në distancë. KPT ofron një gamë laboratorësh kompjuterikë, të pajisur me pajisjet e nevojshme për të mbështetur të nxënësve e studentëve dhe procesin mësimor në tërësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron laboratorët kompjuterikë si pikë të fortë të institucionit. Stafi dhe studentët u shprehën se kompjuterët dhe programet e ofruara nga KPT-ja janë të përshtatshme për nevojat e tyre. Krahas kësaj, mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit, KPT-ja përqendrohet te ndryshimet dhe përmirësimet e vazhdueshme teknologjike për të rritur cilësinë. KPT-ja ka një infrastrukturë të gjerë dhe efikase të teknologjisë së informacionit, që mirëmbahet dhe përmirësohet vazhdimisht **(BM3, BM4, A5) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.15]**
- 2.16 KPT-ja ushtron autonomi financiare në përputhje me rregullat dhe standardet financiare të institucioneve private të arsimit të lartë. Bordi Administrativ miraton buxhetin, që hartohet nga Zyra e Financës dhe administratori. Buxheti diskutohet në të gjitha bordet dhe komitetet përkatëse në Njësitë Bazë dhe në Senatin Akademik. Kolegji Profesional i Tiranës është nën pronësinë e shoqërisë "KPT" SHPK, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, më 20.02.2015. Shoqëria "KPT" SHPK sigurohet se politikat dhe organizimi i studimeve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe qëndrueshmërinë financiare të Kolegjit Profesional të Tiranës. Duke qenë se menaxhimi financiar dhe kontrolli buxhetor janë centralizuar, njësitë akademike kanë autonomi financiare. Transparenca sigurohet falë diskutimit të çështjeve

financiare në Senatin Akademik, që përfshin përfaqësues të stafit dhe studentëve. Procesi i hartimit të buxhetit dhe sistemi i menaxhimit financiar administrativ janë të mirëstrukturuar, efikasë dhe të njohur nga stafi. Për çdo vit akademik, KPT-ja përcakton projektbuxhetin e hollësishëm përkatës, sipas departamenteve dhe kërkesave të tyre. KPT-ja, si një institucion privat i arsimit të lartë, ka strukturë vetëfinancimi. Burimet financiare përfshijnë tarifën e studimit, projekte dhe grante, financim nga partnerët e KPT-së, të ardhura nga shërbimet që KPT-ja iu ofron palëve të treta, dhe burime të tjera të ligjshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon KPT-së që të fillojë t'iu ofrojë shërbime palëve të treta, çka mund të rritë të ardhurat e institucionit. **(BM2, BM5, BM6, A2) [Shtojca Nr. 1, Standardi II.16, II.17, II.18]**

2.17 KPT-ja ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, që përfshin institucione të arsimit të lartë, organe publike dhe firma dhe biznese të pavarura. **(BM2, BM5)** Ndërkombëtarizimi përfshihet si veçori kyç e Strategjisë së Zhvillimit 2021 - 2025. **(A5)** Studentët, stafi akademik, alumnit dhe përfaqësuesit e industrisë treguan për lidhje të forta ndërmjet organizatave vendore dhe atyre rajonale, si dhe stafit akademik të Njësisë Bazë. **(BM3, BM6)** Gjatë mbledhjeve u konstatua aspirata për të shtuar numrin e orëve praktike gjatë studimeve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e ripohon këtë nevojë dhe e nxit KPT-në që të ndërmarrë veprime për të shtuar numrin e orëve praktike për studentët në biznese ose institucione të ndryshme. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.19]**

2.18 KPT-ja ka lidhur marrëveshje partneriteti me institucione shtetërore dhe private në kuadër të ofrimit të shërbimeve ndaj studentëve dhe sigurimit se programet përkatëse të studimit do të përmirësohen dhe përshtaten për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Mbikëqyrja e marrëveshjeve me partnerët menaxhohet nga çdo Njësi Bazë. Zyra e Karrierës dhe Alumnive monitoron punësimin e të diplomuarve dhe mundëson ngritjen e një rrjeti alumnish, ndaj si e tillë, është një zyrë shumë e rëndësishme në KPT që lehtëson marrëdhënien midis studentëve, bizneseve, institucioneve, dhe IAL-së **(BM3, BM6)** **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.20]**

2.19 Kolegji ka ndërmarrë një sërë marrëveshjesh formale që iu mundësojnë stafit dhe studentëve të marrin pjesë në veprimtari ndërkombëtare. Raporti i Vetëvlerësimit pranon se KPT-ja ende po punon për rritjen e numrit të projekteve me institucione të tjera ndërkombëtare. Rekomandohet që KPT-ja të vazhdojë të zhvillojë strategjinë e ndërkombëtarizimit, me qëllim që të garantojë mundësi mobiliteti për stafin dhe studentët, si dhe integrimin e studentëve dhe stafit të huaj me efektshmëri. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.21]**

2.20 KPT-ja synon që të përgatitë studentët jo vetëm për tregun vendas dhe rajonal të punës, duke iu dhënë përvojë evropiane përmes stazheve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata falë projekteve evropiane **(A10)**, por edhe t'i përgatitë drejt tregut të punës nëpërmjet punës praktike gjatë studimeve. KPT-ja synon të krijojë profesionistë të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë sonë. Misioni është të jetë një urë midis arsimit akademik dhe formimit praktik, duke i ndihmuar studentët që të integrohet më lehtë në tregun e punës **(A2)**. Për këtë qëllim, KPT-ja kryen studime periodike tregu sipas nevojave të institucionit. **(A75)** Pavarësisht deklaratës së IAL-së dhe setit të ofruar të dokumenteve, ekspertëve nuk i është mundësuar asnjë studim real tregu. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon KPT-së që të kryejë studime specifike tregu për programe të reja studimi.

Krahas kësaj, duhet t'iu hedhin një sy programeve ekzistuese dhe të vlerësojnë potencialin e tregut për secilin prej tyre. [Shtojca Nr. 1, Standardi II.22]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Infrastruktura dhe veçanërisht laboratorit dhe pajisjet e KPT-së janë të përditësuara dhe mundësojnë praktikë të mirë për studentët dhe stafin akademik. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.12]**
- Bashkëpunimi i ngushtë me partnerët dhe bizneset krijon një perspektivë pozitive për punësimin e studentëve të KPT-së në të ardhmen **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.19]**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Numri i ulët i stafit të brendshëm në kategorinë Profesor. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.1]**

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Rritja e numrit të stafit akademik në kategorinë Profesor. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.1]**.
- Ofrimi i shërbimeve për palë të treta, që rritin të ardhurat e institucionit. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.16, II.17, II.18]**
- Kryerja e studimit të tregut për programe të reja studimi, dhe analizimi i programeve ekzistuese dhe vlerësimi i potencialit të tregut për secilin prej tyre. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.22]**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- KPT-ja ka rritur bashkëpunimin ndërkombëtar përmes projekteve dhe marrëveshjeve të ndryshme me universitete dhe biznese. **[Shtojca Nr. 1, Standardi II.20, II.21].**

Gjykimi

Standardet për Burimet dhe Partneritetin janë përmbushur kryesisht

Fusha e vlerësimit 3: Programet e studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi

- 3.1 KPT-ja është një institucion i akredituar që ofron programe jouniversitare dhe është plotësisht në përputhje me Misionin e parashikuar në Statut (**A2, BM2**). KPT-ja, me dy departamentet e saj, përkatësisht Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, ofron programe që përputhen me nevojat e tregut të punës dhe i shërbejnë ekonomisë vendase. Misioni i KPT-së dhe objektivat e përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit përcaktojnë qartë, përkatësisht, diplomën me të cilën studenti pajiset dhe mundësitë e punësimit. (**BM5/1**). [Shtojca Nr. 1, Standardi III.1]
- 3.2 Strategjia e Zhvillimit e AS-së 2015 - 2020 mbështetet te burime të ndryshme informacioni, studime tregu dhe mënyra të tjera komunikimi me komunitetin e biznesit për të bashkërenduar programet përkatëse me dinamikat dhe nevojat vendore ekonomike për profesionistë të aftë. KPT-ja, përmes programit dyvjeçar, arrin të përgatitë një program që do t'i bëjë studentët të aftë të hyjnë në tregun e punës për një kohë të shkurtër në profesione, që kërkojnë kualifikime dhe formim profesional jouniversitare, duke kontribuar kështu në formimin e të rinjve dhe duke iu shërbyer nevojave të ekonomisë vendase (**A77, BM6**). [Shtojca Nr. 1, Standardi III.2]
- 3.3 KPT-ja e ushtron veprimtarinë e saj sipas sistemit të Bolonjës dhe përkon me Nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në zbatim të Ligjit Nr. 10 247, datë 04.03.2010 "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", i ndryshuar, dhe përaftron Nivelin 5 të Sistemit të Bolonjës. Rezultatet e të nxënit të KPT-së përkojnë me Nivelin e kualifikimit 5, dhe KPT-ja ka infrastrukturën dhe stafin akademik të nevojshëm për arritjen e këtyre rezultateve të të nxënit. KPT-ja ofron programe të akredituara studimi dhe programe jouniversitare të larta, profesionale, me jo më pak se 120 kredite (**A2, A6, BM4**). Objektivat e të nxënit përcaktohen qartë edhe në syllabuse. Aftësitë, objektivat dhe mundësitë e punësimit të programeve të studimit përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit (**A6, A83**). [Shtojca Nr. 1, Standardi III.3]
- 3.4 Institucioni ka krijuar procedura për miratimin e programeve të reja të studimit, të parashikuara qartë në aktet nënligjore dhe rregulloret. Procedurat për hapjen dhe miratimin e programeve të reja të studimit përcaktohen në Statutin e KPT-së, ku njësia bazë dhe Senati Akademik luajnë një rol thelbësor, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të KPT-së. Në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, me aktet rregullatore të KPT-së (**BM2, BM4, A75**) [Shtojca Nr. 1, Standardi III.4]
- 3.5 Institucioni ka infrastrukturë dhe logjistikë të përshtatshme dhe respekton plotësisht kërkesat dhe standardet ligjore për zhvillimin e programeve të studimit. KPT-ja ka krijuar një politikë punësimi dhe zbaton kriteret transparente për punësimin e stafit akademik dhe mbështetjen e stafit administrativ. Politika e punësimit bazohet te dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe tek aktet rregullatore të KPT-së, konkretisht te Statuti (**A2, A4, A21, BM2, BM3, BM4 RVV;**). Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konfirmoi këto procedura nga identifikimi i nevojës për burime njerëzore, propozimi për vende të reja pune, dhe miratimi i vendimit përfundimtar (**M2**). Sa u përket kapaciteteve të stafit, KPT-ja ka punësuar staf akademik dhe administrativ të aftë dhe të mirëpërgatitur. Në veçanti, stafi akademik ishte kombinim i shkëlqyer i stafit të ri dhe stafit me përvojë praktike në sektorin privat. Gjithashtu, numri i personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme përputhet me kërkesat ligjore (**A32, A36**). [Shtojca Nr. 1, Standardi III.5]

- 3.6 Programet e studimit të ofruara nga KPT-ja respektojnë kuadrin shqiptar sipas Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (“Ligji për arsimin e lartë”). Programet e studimit bazohen te Sistemi i Bolonjës i transferimit të krediteve ECTS, duke bërë të mundur mobilitetin e studentëve në programe të ngjashme studimi. Kërkesa minimale për përfundimin e programeve të studimit të KPT-së është 120 kredite **(A2)**. Çdo program studimi në KPT organizohet në kurrikula, që përfshijnë të gjitha elementet, si ngarkesa e punës mbështetur në kreditet ECTS. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.6]**
- 3.7 KPT-ja ka konceptuar programe studimi mbështetur në nevojat e tregut të punës për të plotësuar mungesat e aftësive profesionale. Duke marrë parasysh stafin e mirëpërgatitur, infrastrukturën dhe kurrikulat e mjaftueshme, studentët e KPT-së mund të përvetësojnë njohuri dhe aftësi praktike, si dhe t’i zbatojnë në botën e vërtetë. Studentët e KPT-së përftojnë njohuri të mjaftueshme në fusha teknike dhe kryejnë punë praktike në laboratorë të mirëpajisur. Kurrikulat ofrojnë një kombinim të mirë të teorisë dhe praktikës, çka ofron bazën e zhvillimit të kompetencave profesionale të të diplomuarve të KPT-së. KPT-ja ofron edhe shërbime mentorimi dhe këshillimi për studentët, me qëllim që t’i njohë me detyrimet akademike të programit, duke identifikuar problematika, vështirësi ose probleme të mundshme dhe duke i zgjidhur/adresuar. Studentët monitorohen nga Pedagogu mbikëqyrës që emërohet nga Departamenti dhe finalizojnë praktikën me mbrojtjen e zhvilluar në komisionin e miratuar nga Departamenti **(A7, A83, A87, A112, BM2, BM3, BM5, BM10)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.7]**
- 3.8 Institucioni ofron programe studimi, shërbime, mjete, dhe kërkim për të ndihmuar në mbylljen e hendeqeve dhe për t’iu shërbyer studentëve të të gjithë moshave nëpërmjet programeve të shumëllojshme. Aktualisht, KPT-ja ofron studime profesionale 2-vjeçare, me kohë të plotë, dhe jouniversitare. Sikundër përmendet në RVV, aktualisht nuk ka programe studimit të edukimit të vazhdueshëm, por ofrohen një shumëllojshmëri kursesh, trajnimesh dhe certifikimesh **(<https://kolegijprofesional.edu.al/kurse-profesionale/>, A2, A37)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.8]**
- 3.9 KPT-ja është një institucion jouniversitar, programet e studimit të të cilit përqendrohen në kërkimin e aplikuar, në përputhje me Nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Sikundër pohohet në RVV dhe u konfirmua gjatë vizitës, KPT-ja kryen veprimtari kërkimi të aplikuar në masën e nevojshme për ofrimin dhe zhvillimin cilësor të programeve të studimit. Elementet e kërkimit shkencor janë përfshirë në procesin mësimor. Krahas kësaj, KPT-ja e mbështet stafin akademik në përfundimin e gradave shkencore dhe i mundëson laboratorët për kërkimet. Puna kërkimore e stafit akademik përcaktohet nga Departamenti sipas akteve rregullatore të KPT-së dhe konsiderohen produkte kërkimore **(A4, A41, A86)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.9]**
- 3.10 Monitorimi i programeve të studimit realizohet nga IAL-ja nëpërmjet strukturave të brendshme organizative - Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC), të përbërë nga një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve dhe kryhet me periudha të rregullta. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, KPT-ja i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe institucional dhe programeve të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në fillim të çdo viti, KPT-ja, nëpërmjet NjsBC-së, miraton një plan pune dhe kryen mbikëqyrje periodike të zbatimit të planeve të programeve të studimit. Përveç kësaj, KPT-ja ka kritere të tjera për vlerësimin e performancës

akademike të stafit, përfshirë dhe udhëheqjen e duhur të mësimdhënies së personelit akademik siç përcaktohet nga standardet e ASCAL-it. Personeli akademik ka për detyrë të përditësojë periodikisht përmbajtjen dhe literaturën e moduleve lëndore, duke pasqyruar kërkimin individual në kurrikul dhe vërejtjet e studentëve. Përgatitja e shënimeve të leksioneve nga stafi akademik për studentët është shembull i shkëlqyer i përditësimit të literaturës. Këto shënime leksionesh janë shumë të rëndësishme për të nxënin e tendencave të reja teknologjike nga studentët, duke marrë parasysh literaturën e ndryshueshme me shpejtësi në fushat e teknologjisë **(A3, A4, A6, A22, A23)**. [Shtojca Nr. 1, Standardi III.10]

3.11 KPT-ja i përmirëson rregullisht programet e studimit, përfshirë dhe përditësimin e kurrikulave, infrastrukturës dhe labororëve, për të krijuar një mjedis të frytshëm të nxëni. Këto ndryshime bazohen te zhvillimet e reja në teknologji. Stafi akademik i KPT-së është shumë i lidhur me industrinë dhe sektorin privat dhe kjo u ka mundësuar marrjen e informacioneve të dorës së parë për trendet e reja të teknologjisë dhe pasqyrimin e tyre në kurrikulë duke marrë në konsideratë listën e profesioneve dhe kërkesat e tregut të punës sipas rregulloreve të brendshme dhe akteve nënligjore në fuqi. **(A3, A4, A19)**. Strategjia e KPT-së bazohet dhe te hulumtimi i tregut dhe rrjeti i të diplomuarve **(A5)**. NjSBC-ja ka hartuar një pyetësor për studentët, për të parë se si e vlerësojnë mësimdhënien e çdo pedagogu, parë nga çdo aspekt, si leksionet, puna praktike dhe labororët. Ky pyetësor shpërndahet në fund të semestrit, dhe vërejtjet merren parasysh gjatë rishikimit dhe përditësimit të programeve të studimit. **(A4)**. Së fundmi, KPT-ja përdor sistemin e gjurmimit për të monitoruar punësimin e studentëve si tregues performance i programit të performancës së tregut **(A20)**. [Shtojca Nr. 1, Standardi III.11].

3.12 Sa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, KPT-ja ka një politikë të qartë të institucionalizuar nëpërmjet akteve nënligjore dhe rregulloreve. KPT-ja e ka ngritur NjSBC-në si organin kryesor përgjegjës për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës. Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, KPT-ja mbështet dhe zhvillimin e stafit akademik nëpërmjet programeve të ndryshme trajnimi dhe në projekte të ndryshme, si përvojat më të mira në lidhje me ndërkombëtarizimin nga partnerë të ndryshëm në brendësi të projekteve Erasmus + CBHE, VET Mobility. **(A2, A4, A35)**. [Shtojca Nr. 1, Standardi III.12]

3.13 Programet e studimit të ofruara nga KPT-ja zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional dhe kombëtar. Programet e studimit ofrohen me kohë të plotë, të organizuara në module ose kurse speciale, të shprehura në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS) dhe zonës evropiane të studimit. Programet e studimit organizohen sipas dispozitave të Kartës së Bolonjës. **(A2, A90)** [Shtojca Nr. 1, Standardi III.13].

3.14 Institucioni ofron programe studimi që i pajisin studentët me dijet dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin praktik të kurseve teorike. Mjediset moderne të punës dhe labororët e pajisur më së miri ofrojnë mundësitë e duhura për të nxënë aftësi praktike. Veç kësaj, programet e lëndëve ndahen në kredite që shndërrohen në seksione sipas raportit përkatës të leksioneve, ushtrimeve dhe labororëve, që ndiqen nga studentët në ambientet dhe labororët e KPT-së, ose, në disa raste, në biznese dhe vizita individuale në terren. Gjithashtu, projektet e tezave të mbikëqyrura janë të zbatueshme dhe të mbikëqyrura nga afër nga stafi, duke u mundësuar studentëve të mësojnë dije të reja dhe të aplikojnë në botën reale. Në klubet studentore zhvillohen aktivitete të tjera studentësh. Studentëve u kërkohet të kryejnë dhe një praktikë profesionale, që zhvillohet në

semestrin e katërt, në fund të vitit të dytë dhe të marrin dhjetë kredite (210 orë praktike). Studentët monitorohen nga Pedagogu mbikëqyrës që emërohet nga Departamenti dhe finalizojnë praktikën me mbrojtjen e zhvilluar në komisionin e miratuar nga Departamenti **(A7, A37, A53)** **[Aneksi Nr. 1 , Standardi III.14]**

- 3.15 Mjedisi i mirë i të nxëniet (infrastruktura dhe laboratorët), stafi i përshtatshëm dhe kurrikulat e mirëhartuara, të bazuara te nevojat e tregut të punës, mundësojnë bazën për misionin e programeve të studimit lidhur me garantimin e pjesëmarrjes aktive të studentëve për përvetësimin e kompetencave. Sistemi i dyfishtë i KPT-së, i ndërthurur me aspekte të mira teorike të mësimdhënies dhe dije dhe aftësi praktike, u mundëson studentëve/të diplomuarve të përshtaten lehtësisht me përgjegjësitë e tyre gjatë ushtrimit të detyrës. **(A4, A6, A45)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.15]**
- 3.16 KPT-ja ka zhvilluar programe studimi në harmoni me nevojat e tregut të punës, ka siguruar infrastrukturë dhe staf akademik të përshtatshëm, dhe ka ofruar mundësi zhvillimi profesional për stafin akademik, që sjell performancë më të mirë mësimore dhe u mundëson studentëve përvetësimin e aftësive praktike. Nga ana tjetër, dijet dhe aftësitë praktike bëjnë të mundur që studentët të kenë performancë dhe përshtatje më të mirë në detyrë. **(A4, A6, A7)**. **[Shtojca Nr.1, Standardi III.16]**
- 3.17 Programet e studimit janë projektuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me standardet evropiane të fushës së studimit (dispozitat e Kartës së Bolonjës) dhe promovojnë mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë. **(A2)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.17]**.
- 3.18 KPT-ja ka përcaktuar një sërë rregulloresh që parashikojnë qartë modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijeve, veçanërisht provimet dhe riprovimet që duhet të japin studentët dhe stafi akademik. Këto përfshijnë procedura dhe rregulla për hartimin e tezave, monitorimin dhe fshehtësinë e provimeve, të drejtën e studentit për të hyrë ose jo në provim, dhe vlerësimin e studentëve. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentëve. Mbrojtja bëhet me paraqitjen e tezës së diplomës ose me dhënien e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, sipas vendimit të rektorit për çdo vit akademik. Për të gjitha këto procedura, studentët informohen për rregulloret dhe procedurat që kanë të bëjnë me provimet dhe diplomimin nëpërmjet tutorimit, komunikimit me e-mail para provimit, sekretariatit akademik, titullit të kursit dhe publikimit në ambientet e KPT-së. Formati i diplomës së programeve të akredituara të KPT-së miratohet përkatësisht nga QSHA-ja. **(A4, A93)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.18]**
- 3.19 Institucioni ofron një infrastrukturë të mirë, me laboratorë të dedikuar për të mbështetur programet e studimit dhe kërkimin shkencor/artistik. KPT-ja zotëron njësi moderne mësimdhënieje dhe administrative, si laboratorë, qendra studentore, pajisje dhe mjete, biblioteka dhe njësi të tjera që kryejnë studime, stazhe, dhe shërbime për zhvillimin e procesit arsimor dhe mësimdhënies. **(A2, A4, A5)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.19]**
- 3.20 Institucioni ofron pajisje të përshtatshme laboratorike, krahas infrastrukturës dhe shërbimeve për mbështetjen e programeve të studimit. KPT-ja ka marrë pjesë aktive në projekte

ndërkombëtare dhe ka përfituar nga projektet ndërkombëtare (Erasmus + CBHE USIA, Engine). Institucioni i ka përmirësuar vazhdimisht laboratorët sipas kërkesave të pedagogut të secilës lëndë, të paraqitura në Departament. Stafi akademik që punon në laboratorë zotëron kapacitete dhe përvoja praktike. Departamenti i shqyrton dhe miraton kërkesat sipas buxhetit të parashikuar. Secili laborator ka të përcaktuara rregullat përkatëse të sigurisë teknike, që janë element thelbësor për orët e para të mësimdhënies në KPT. Çdo ambient laboratorik i ka vendosur në dispozicion personelit akademik manualin përkatës. Të gjitha zyrat e personelit akademik dhe administrativ janë pajisur me kompjutera dhe kanë akses tek infrastruktura mbështetëse, si printerat, fotokopjet dhe skanerët. **(A4, A5, A10, A45, A46). [Shtojca Nr. 1 Standardi III.20]**

3.21 KPT-ja ka ambiente dhe infrastrukturë të përshtatshme biblioteka, si dhe shërbime që mundësojnë aksesin të literaturës bashkëkohore lidhur me fushat e studimit të programeve dhe kërkimit. Përveç burimeve dhe librave të bibliotekës, KPT-ja ka një platformë online për libra, të lidhur me biblioteka universitare prestigjioze në mbarë botën. Libraria online aksesohet nëpërmjet linkut <https://kolegijiprofesional.edu.al/online-library-oe> (Burimet e Hapura Arsimore (BHA)). Biblioteka ofron materiale mësimore dhe kërkimore të lëshuara me një licencë të hapur që lejon aksesin, përdorimin, ripërdorimin dhe rishpërndarjen nga të tjerët, të pakufizuar ose të kufizuar. Përveç kësaj, stafi i KPT-së botoi edhe disa libra dhe shënime leksionesh që ofrohen nga kjo Bibliotekë. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës rregullohet nga një rregullore e veçantë e publikuar në ambientet e saj, bashkë me orarin e përdorimit. **(A10, A94, A94/1, A96) [Shtojca Nr. 1, Standardi III.21]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Në veçanti, Laboratori i Inovacionit dhe stafi i ri janë shembuj të mirë. **[Shtojca Nr. 1 , Standardi III.20]**

Pikat e dobëta

Ekipi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Ekipi i Vlerësimit nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Ekipi i Vlerësimit nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Programet e Studimit, Mësimdhënien dhe Vlerësimin janë përbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 4: Veprimtaria Shkencore/Artistike dhe Inovacioni

- 4.1 Institucioni ofron programe studimi bazuar te ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ("Ligji për Arsimin e Lartë"), Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 26.04.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit të Lartë Profesional, Urdhri nr. 426, datë 06.11.2015, "Për lejen e ushtrimit të veprimtarisë akademike", si dhe te aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi. **(A2)**. KPT-ja kryen kërkime të aplikuara në masën e nevojshme për nevojat e zbatimit të programeve të studimit të karakterit profesional në përputhje me misionin dhe aktet e saj nënligjore, si dhe ofron shërbime. KPT-ja ka vendosur objektiva strategjike në vizionin dhe misionin e saj, të përkthyer në strategjinë e saj kërkimore **(A5)** dhe, ndër të tjera, synon të sjellë risi në aktivitetet e aplikuara dhe ato kërkimore. Infrastruktura dhe laboratorët mundësojnë një mjedis të mirë pune për stafin dhe studentët që të kryejnë kërkime të aplikuara dhe të testojnë produkte dhe inovacione të reja. Projekte në Shqipëri, të tilla si Erasmus +, CBHE, University to Society Innomediaries: Bashkëprodhimi i rëndësishëm i dijeve dhe kërkimit." Mund të nxisë inovacionin dhe kërkimin. **[Shtojca Nr.1, Standardi IV.1]**
- 4.2 Institucioni i përmbush pjesërisht prioritetet e kërkimit shkencor. Njësitë bazë i përcaktojnë prioritetet duke ndjekur prioritetet institucionale për kërkimin dhe zhvillimin, duke u fokusuar te qasjet e BE-së, si digjitalizimi, teknologjitë SMART dhe energjia e rinovueshme dhe e gjelbër në kontekstin e diskutimeve gjithëpërfshirëse. **(A5)**. KPT-ja është pjesë e disa aktiviteteve ndërkombëtare, por pak përfshihen drejtpërdrejt me aktivitetet kërkimore që promovojnë kërkimin **(BM2, BM4)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.2]**
- 4.3 Institucioni bën përpjekje të konsiderueshme për të nxitur zhvillimin e veprimtarive shkencore. KPT-ja ofron një mjedis të mirë pune për kërkimet dhe inovacionin e stafit akademik dhe studentëve. Garanton lirinë akademike të shprehur nëpërmjet respektimit të diversitetit të mendimeve, ideve dhe metodave dhe zhvillimin e lirë, kritik dhe krijues të mësimdhënies dhe organizimit të saj **(A2, A10)**. KPT-ja e fton dhe e nxit stafin që të botojë dhe e mbështet në këtë drejtim duke e informuar dhe duke organizuar evente që i promovojnë këto aktivitete **(A33)**. *Meqithatë, këto botime në të ardhmen duhet të orientohen drejt revistave më të njohura ndërkombëtare.* Infrastruktura, laboratorët dhe pajisjet e përshtatshme duhet të krijojnë një mjedis të mirë kërkimor për prodhimin e rezultateve kërkimore me cilësi të lartë. Një shembull i shkëlqyer i këtyre përpjekjeve përfshin KPT HUB - Klubi i Inovacionit që u krijua për të bashkuar studentët që praktikojnë dijet dhe zbatimin e projekteve të ndryshme, në grupe apo individualisht, me mbështetjen dhe udhëzimet e mentorëve përkatës në elektronikë, robotikë, programim, etj., sipas prioritetëve. **(A53)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi III.3]**.
- 4.4 KPT-ja mbikëqyr vlerësimin e performancës në nivel institucional të njërive përgjegjëse për kërkimin dhe inovacionin. NjSBC-ja është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë **(A2, A31)**. **[Shtojca Nr.1, Standardi IV.4]**
- 4.5 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në kërkimin shkencor dhe i përdor për të siguruar zhvillimin e tij ekonomik dhe financiar. Lidhur me pronësinë e rezultateve kërkimore ose produkteve të personelit akademik, Kontrata e Punës parashikon se produktet e krijuara nga Punonjësi si rezultat i kryerjes së detyrave të tij sipas kontratës mbeten në pronësi

ekskluzive të KPT-së - sipas dispozitave të Kodit të Punës, nenet 135 dhe 136. Pas përfundimit të shërbimit sipas kontratës, pedagogu duhet t'ia dorëzojë produktet e shërbimit të tij KPT-së në kopje fizike dhe/ose elektronike. Palët bien dakord që e drejta për përfitimin e produkteve nga Pedagogu është e përjashtuar shprehimisht. **(A32)**. Këtu nuk përfshihen produktet e prodhuara nga studentët. Veç kësaj, KPT-ja duhet ta rishqyrtojë pronësinë intelektuale duke nxitur më shumë studentë dhe pedagogë që të punojnë dhe të prodhojnë inovacione dhe kërkime në kuadër të KPT-së. **[Shtojca Nr.1, Standardi IV.5]**

4.6 KPT-ja përbëhet nga dy departamente, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, nëpërmjet të cilave KPT-ja organizon aktivitete mësimore dhe kërkimore. Këto dy njësi nxisin, programojnë, koordinojnë, zhvillojnë, organizojnë dhe administrojnë aktivitetet mësimdhënëse, trajnuese dhe kërkimore të zbatuara në masën e nevojshme dhe në vijim të programeve të studimit profesional. Departamenti ka të paktën pesë anëtarë, punonjës me kohë të plotë, si staf mësimdhënës, nga të cilët të paktën dy pedagogë me grada shkencore ose tituj akademikë. **(A2)**. Laboratorët dhe hapësirat praktike të punës organizohen dhe sipas lëndëve në terren, që mund të përdoren për aktivitete kërkimore në fusha të ngjashme. **(Tur i mjediseve)** KPT-ja ka dhe një njësi të veçantë për transferimin e teknologjisë dhe bashkëpunimin me sektorin privat, qëllimi i së cilës, ndër të tjera, është t'ua vërë kërkimet e KPT-së në dispozicion palëve të interesit **(A38)**. Kjo njësi mund të përdoret për të koordinuar aktivitetet kërkimore në nivel KPT-je. **[Shtojca Nr.1, Standardi IV.6]**

4.7 KPT-ja ka një strategji dhe Politikë të Kërkimit të Aplikuar që i harmonizon prioritetet e saj të kërkimit dhe zhvillimit në përputhje me prioritetet afatgjata rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, por në kontekstin e natyrës, theksi vihet te kërkimi i aplikuar dhe te bashkëpunimi me sektorin privat. KPT-ja e lehtëson, e mbështet dhe e nxit stafin akademik që të kryejë kërkime të aplikuara dhe të ndjekë studime të mëtejshme për master dhe doktoraturë. Përfshirja e stafit në projekte ndërkombëtare bazohet te parimi i gjithëpërfshirjes, duke marrë parasysh fushat e ekspertizës dhe përvojës, transparencën dhe ndarjen e informacionit, si punë individuale apo në grup **(A35, A67, A86)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.7]**

4.8 Institucioni i KPT-së synon t'i shtojë aktivitetet e vazhdueshme kërkimore dhe shkencore dhe garanton përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë. Një pjesë e stafit të KPT-së, edhe pse jo e detyrueshme, kanë doktoratura dhe master në fusha të afërta, që mund të përdoren si burim për projekte kërkimore dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së projekteve të tyre të aplikuara kërkimore ose stazheve. KPT-ja synon të bëhet qendër inovacioni teknologjik nëpërmjet vendosjes së marrëdhënieve të ngushta bashkëpunuese me institucione të ngjashme rajonale dhe më gjerë. Bazuar te dispozitatat ligjore të ligjit 80/2105, neni 72, kreditet e grumbulluara gjatë studimeve të larta profesionale mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kritereve të përcaktuara nga IAL-të. Nisur nga kjo, KPT-ja ka përcaktuar si misionin e saj, ndër të tjera, sigurimin e një baze të mjaftueshme dijesh për të mundësuar transferimin e studimeve në nivelet më të larta universitare. **(A2, BM2, BM3, BM10)**. Kjo e lehtëson lëvizshmërinë e studentëve dhe të stafit. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.8]**

- 4.9 KPT-ja bën përpjekje të konsiderueshme për t'i botuar rezultatet e marra në fushat e kërkimit shkencor. Në dokumentet e politikave të veta, KPT-ja thekson qartë se një nga objektivat kryesore është ndërgjegjësimi i sektorit privat dhe komunitetit për rezultatet e hulumtimit **(A86)**. KPT-ja e fton dhe e nxit stafin që të jetë pjesë e punës kërkimore që kontribuon për zhvillimin e aktiviteteve akademike si kurrikulat për KPT-në apo të kontraktuara nga palë të treta, duke ofruar ekspertizë, përpunimin e metodologjive dhe modeleve, për të botuar dhe ndihmuar në këtë drejtim duke shkëmbyer informacion dhe duke organizuar evente që i promovojnë këto aktivitete **(A33)**. KPT-ja ka një bazë të dhënash me artikuj, botime etj. që bëhen pjesë e arkivit të KPT-së. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.9]**
- 4.10 KPT-ja ka miratuar Kodin e Etikës dhe Integritetit që përcakton parime të shëndosha për integritetin akademik, *inter alia*, botimet, kërkimet, etj. **(A11)**. Kodi i Etikës dhe Integritetit garanton cilësinë e punimeve shkencore dhe integritetin e tyre në nivel institucional. Nga pikëpamja institucionale, KPT-ja ka krijuar edhe një Këshill Etike, që është pjesë e organeve akademike drejtuese të KPT-së **(A2)**. Këshilli përbëhet nga 5 anëtarë. Një nga anëtarët e Këshillit të Etikës është përfaqësues i studentëve. **(A2)**. Këshilli siguron kryerjen e veprimtarive kërkimore dhe mësimore në përputhje me Kodin e Etikës. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.10]**
- 4.11 KPT-ja i përcakton kërkesat për personelin akademik në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore, studime dhe botime dhe mbështet vetërealizimin e tyre. Puna kërkimore në KPT është kërkim i aplikuar bazuar te profili i institucioneve për ofrimin e kompetencës profesionale për studentët, që përkon me Nivelin 5 në kuadrin e Kualifikimit Shqiptar. Kriteret e përfshirjes në aktivitetet kërkimore përcaktohen në nivel departamenti dhe raportohen periodikisht nga Departamenti. KPT-ja miraton shumë iniciativa për projekte kërkimore në bashkëpunim me industrinë ose biznesin. **(A41, A86)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.11]**
- 4.12 Institucioni e ka përcaktuar kërkimin shkencor si prioritet strategjik deri në shkallën e duhur të kërkuar që përkon me Nivelin 5 në kuadrin e Kualifikimit Shqiptar **(A2, A41, A86)** **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.12]**
- 4.13 KPT-ja e ushtron veprimtarinë e saj sipas sistemit të Bolonjës dhe përkon me Nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në zbatim të Ligjit Nr. 10 247, datë 04.03.2010 "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", i ndryshuar, dhe përafrohet me Nivelin 5 të Sistemit të Bolonjës. Ky sistem krijon kushtet për mobilitetin e stafit dhe studentëve, dhe përfshin dhe diasporën në mësimdhënie dhe kërkime. Përfshirja e lartë e KPT-së në projektet ndërkombëtare, veçanërisht të Erasmus-it, mundëson përfshirjen e të huajve dhe diasporës. Gjithashtu, politika, kriteret dhe procedurat e punësimit në KPT rregullohen sipas dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe sipas akteve rregullatore të KPT-së, veçanërisht Rregullores së Statutit të KPT-së dhe Manualit të Burimeve Njerëzore që synojnë punësim stafi sa më cilësor. Treguesit e performancës së kandidatëve janë ndër kriteret kryesore ku bazohet vlerësimi i rekrutimit të kandidatëve. Ata përfshijnë cilësinë dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke u dhënë përparësi universiteteve përëndimore. **(A2, A4, A31)** **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.13]**
- 4.14 KPT-ja promovon një politikë gjithëpërfshirëse të stafit dhe studentëve në mësimdhënie, kërkime dhe projekte ndërkombëtare, që mundësojnë dhe përfshirjen e stafit në aktivitete kërkimore, si dhe stazhin për studentët, nën mbikëqyrjen e pedagogëve, në kompani evropiane

duke rimbursuar të gjitha kostot e projektit. Një shembull i shkëlqyer i takimit me studentët e KPT-së ishte pjesëmarrja si mentorë për TIK-un në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Stazhe të tjera u kryen në Budapest, Hungari, në kuadër të Projektit „Connected through Mobility“. Stafit mësimor i KPT-së ka marrë pjesë dhe në trajnime interaktive online dhe trajnime me prani fizike për të zhvilluar dhe rritur kapacitetet dhe ndërkombëtarizimin e tyre. Projekte të tilla u ofrojnë përvojë evropiane stafit dhe studentëve nëpërmjet praktikave afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, falë projekteve evropiane **(A10, A34) [Aneksi Nr. 1, Standardi IV.14]**

4.15 KPT-ja u është qasur prioriteteve të saj kërkimore dhe zhvillimore nga pikëpamja e kërkimit të aplikuar për nivelin përkatës 5 të IAL-së, ku theksohet kërkimi i aplikuar. Prioritetet e KPT-së për kërkimin dhe zhvillimin janë të përafuara me objektivat e BE-së, si digjitalizimi, teknologjitë SMART, energjia e rinovueshme dhe e gjelbër në kuadër të diskutimeve gjithëpërfshirëse dhe zgjerimit të rrjetit të partnerëve dhe bashkëpunëtorëve brenda dhe jashtë vendit. **(A5) [Shtojca Nr. 1, Standardi IV.15]**

4.16 Institucioni siguron transferimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në dobi të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit nëpërmjet bashkëpunimit me sektorin privat **(A2)**. KPT-ja synon të kontribuojë për zhvillimin ekonomik të vendit duke krijuar profesionistë të aftë me dije dhe aftësi kërkimore për t'i shërbyer shoqërisë dhe ekonomisë sonë, duke kryer kërkime të aplikuara akademike dhe duke ofruar zgjidhje biznesi në kontekstin e kompanive. KPT-ja i ndan arritjet e kërkimeve të aplikuara me palët e interesit brenda IAL-së dhe aktorët e jashtëm. Edhe shkëmbimet e stafit nëpërmjet bashkëpunimeve ndërkombëtare përmirësojnë shpërndarjen lokale dhe globale të gjetjeve të kërkimeve. **(A27, A41, A72, A77)**. Për më tepër, Zyra e USIA-s do të ndihmojë përmirësimin e kapacitetit të KPT-së për të prodhuar dije dhe kërkime me ndikim në bashkëpunim, duke mundësuar transferimin e dijeve dhe ndërmjetësimin e inovacionit. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.16]**

4.17 KPT-ja ndodhet në një pozicion të mirë për ta komercializuar kërkimin nga aktivitetet e tyre. Infrastruktura dhe stafi siguruan një bazë të fortë për zgjerimin e ardhshëm të shërbimeve dhe kërkimeve të aplikuara që sjellin përfitime financiare për KPT-në. Aktualisht, aktivitetet kërkimore dhe përfshirja e stafit kryesisht në projekte ndërkombëtare financohen nga donatorët dhe *KPT-ja duhet të synojnë rritjen e të ardhurave për aktivitetet kërkimore dhe portofolin e shërbimeve të ofruara nga stafi i saj.* **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.17]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Praktika në vende të tjera. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.14]**

Pikat e dobëta

Ekipi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Të punohet për projekte specifike me sektorin privat që përfshin kërkime të aplikuara. KPT-ja duhet të synojë rritjen e të ardhurave për aktivitetet kërkimore dhe portofolin e shërbimeve të stafit të saj. **[Shtojca Nr. 1, Standardi IV.17]**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Ekipi i Vlerësimit nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Veprimtarinë Shkencore/Artistike dhe Inovacionin janë përmbushur kryesisht

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e Tyre

- 5.1 KPT-ja ka miratuar rregulla dhe rregullore, procedura dhe politika për përzgjedhjen dhe pranimin e studentëve. Numri i pranimeve të studentëve përcaktohet sipas kriterëve dhe kufizimeve ligjore të miratuara nga organet shtetërore dhe aktet e tyre përkatëse. Autoritetet drejtuese të KPT-së kanë marrë parasysh kapacitetet e infrastrukturës, burimet njerëzore dhe kërkesat e tregut të punës. Në vijim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, me aktet rregullatore të KPT-së, dhe veçanërisht me Strategjinë e Zhvillimit të KPT-së 2015 - 2020, KPT-ja synoi të zgjerohej horizontalisht (duke pasuruar ofertën e saj akademike me 3 programe të reja studimi). Kuotat e pranimit dhe kriteret e pranimit shqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga Senati Akademik **(A85)**, dërgohen në organet përkatëse, postohen në portalin U Albania dhe bëhen publike dhe përditësohen në faqen e KPT-së <https://kolegijiprofesional.edu.al/regjistrimi/>. Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kriteret minimale për të hyrë në programin e studimit. KPT-ja rekruton dhe studentë të huaj në programet e studimit. Të gjitha procedurat për pranimin janë transparente. KPT-ja miraton një strategji marketingu dhe komunikimi bazuar te parimi themelor që është transparenca në komunikim, plotësia, vërtetësia dhe qartësia e informacionit dhe aksesi të informacioni **(A63)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi V.1]**
- 5.2 KPT-ja ofron mbështetje të vazhdueshme përmes shërbimeve universitare për studentët e saj, që nga fillimi i tyre deri në përfundimin e tyre ose lehtëson lëvizshmërinë. Sigurimi i mbështetjes bëhet kryesisht nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informacionit, që luan rol të rëndësishëm për informimin dhe pranimin e studentëve. Çdo vit, organizohet Java e Orientimit Studentor **(A29)**, ku studentët e rinj njihen dhe familjarizohen me jetën studentore, orarin, ku të kërkojnë informacion etj., nën drejtimin e pedagogëve dhe Zyrës së BNJ dhe Kontratave dhe Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informacionit. Zyra e Karrierës organizon dhe vizita në ambientet e KPT-së, ku ftohen të marrin pjesë maturanët, mësuesit dhe prindërit **(A89)**. Mbështetja e studentëve bëhet dhe duke shkëmbyer informacion në faqen e internetit dhe rrjetet sociale. KPT-ja është pjesëmarrëse e rregullt në panairt e organizuara ndër vite nga Dhoma e Tregtisë, “Puna dhe Studimi”, ku e promovon me përkushtim dhe këmbëngulje ofertën e saj akademike (Panairt e Evidencës 76 “Puna dhe Studimi” ndër vite). KPT-ja merr pjesë dhe në panairt të organizuara nga organizata dhe institucione të ndryshme që promovojnë IAL-të dhe arritjet në fushën e ndërkombëtarizimit, që luajnë rol thelbësor për cilësinë e programeve të studimit **(A95)**. Një formë tjetër mbështetjeje përfshin mbikëqyrjen e mësuesve dhe shërbimet këshilluese në lidhje me të nxënin. **[Shtojca Nr. 1, Standardi V.2]**
- 5.3 Institucioni KPT përdor një sistem efikas informimi të studentëve. Te të gjitha këto shërbime, zyra e TI-së luan rol të rëndësishëm për ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për Politikën e Internetit, E-mail-it dhe Infrastrukturës së TI-së **(A102)**. Komunikimi brenda dhe jashtë institucionit bazohet te Politika e Përdorimit të Internetit, E-mail-i dhe Infrastruktura e TI-së **(A63)**. Faqja zyrtare e KPT-së publikon dhe përditëson informacione të plota, të sakta dhe të detajuara për portofolin dhe ofertën akademike të KPT-së (<https://kolegijiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/>) dhe ka informacion të mjaftueshëm për shërbimet e studentëve, programet e studimit, të rejtat, botimet dhe lidhje të tjera me platformat. KPT-ja ka një bazë të dhënash me informacione për studentët, që përmban adresën, adresën e e-mail-it dhe numrin e telefonit të secilit student, si dhe një numër anëtar i familjes për çdo rast. Në qendër të këtij komunikimi

është Sistemi Classter (Dëshmia 59 - Sistemi i I Institucional Classter). KPT-ja ka Classter, një sistem që mirëmbahet dhe përditësohet vazhdimisht **(BM3, BM4, A59)**. [Shtojca Nr. 1, Standardi V.3]

5.4 KPT-ja e inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale nëpërmjet formave të ndryshme dhe kjo deklarohet dhe në dispozitat e Statutit **(A2)**. Studentët kanë përfaqësues në Këshillin Studentor dhe marrin pjesë në qeverisjen e institucionit. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie qendrore, në nivel të institucioneve të arsimit të lartë dhe në nivel kombëtar. Aplikimet për këshillin studentor janë publike dhe çdo student mund të aplikojë për t'u zgjedhur. Gjatë vizitave rishikuese, kemi vënë re se studentët ishin të mirinformuar për këto struktura dhe përfaqësuesit e pranonin plotësisht rolin e tyre. KPT-ja ofron një ambient të mirë mësimor dhe një ambient të mirë për jetën shoqërore dhe aktivitetet sportive **(BM3, Turi i Mjediseve)**. [Shtojca Nr. 1, Standardi V.4]

5.5 KPT-ja ndjek politika për orientimin dhe këshillimin e studentëve për studentët aktualë dhe potencialë. Siç thuhet në 5.2, Politika e Komunikimit e KPT-së ofron këshillim për të diplomuarit gjatë procesit të përzgjedhjes së arsimit të lartë dhe programeve të studimit, si Karriera e Studentëve, Zyra e Mbështetjes dhe Informacionit - për informacion rreth Kolegjit; organizimi i jetës studentore etj. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave. Stafi luan rol jetik për dhënien e shpjegimeve të nevojshme për orientimin dhe këshillimin e të diplomuarve. KPT-ja përgatit broshura të ndryshme informuese për të dhënë një panoramë të plotë, të qartë dhe të saktë të IAL-ve **(A105)**, ku një element i shtuar është kodi QR që i drejton te faqet zyrtare të internetit të KPT-së. Studentët aktualë në KPT janë shërbime nëpërmjet Karrierës së Studentëve, Mbështetjes dhe gjithashtu nëpërmjet mentorëve, mbikëqyrësve dhe stafit tjetër mbështetës në laboratorë, mbështetja për pajisjet e TI-së, përdorimi i burimeve të bibliotekës etj. **(BM3, BM10, A63, A102)**. Studentët njihen me informacionin kryesor për jetën studentore nëpërmjet "Manualit të Studentit" (Dëshmia 99 - Manuali i Studentit) dhe merr vazhdimisht komunikime dhe informacione për çështje të ndryshme të jetës studentore dhe të procesit akademik **(A65)** [Shtojca Nr.1, Standardi V.5]

5.6 KPT-ja ka politika mbështetëse dhe ka zbatuar forma të ndryshme për kategori të veçanta sociale dhe aktivitete jashtëshkollore. KPT-ja e ka theksuar në RVV të drejtën për arsimim, si të drejtë kushtetuese dhe vëmendjen ndaj përgjegjësisë sociale. E drejta për arsimim për të gjitha grupet e marginalizuara është e rëndësishme, veçanërisht për lehtësimin e aksesit të shërbimeve arsimore për personat me aftësi të kufizuara. KPT-ja ka miratuar Rregulloren për Studentët me Aftësi të Kufizuara. KPT-ja ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara dhe i ka trajtuar çështjet e ngritura nga grupi i fundit i shqyrtimit të akreditimit. Një shembull i shkëlqyer i një politike të tillë mbështetëse është sigurimi i kuotave për grupet e pakicave etnike, si nxënësit e minoritetit rom dhe ballkano-egjiptian. KPT-ja ofron një ambient të mirë mësimor dhe ambiente të përshtatshme për jetën shoqërore, sportet dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore si trajnime, fushata ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja në dhurimin e gjakut, iniciativat sociale bamirëse, kampionate dhe aktivitete sportive, gara (p.sh. pjesëmarrja në *hackathone*, gara fotografish, **(A37, A40, Facility Tour)**. [Aneksi Nr. 1, Standardi V.6]

5.7 KPT-ja ofron literaturë të mjaftueshme ndihmëse për studentët për dy departamente. Që nga akreditimi i fundit, KPT-ja është përpjekur dhe e ka pasuruar Bibliotekën me tituj të rinj dhe literaturë përkatëse. Çdo silabus kursi **(A83)** ofron literaturën përkatëse, të klasifikuar në literaturë

të detyrueshme dhe ndihmëse, në shqip dhe/ose anglisht. Literatura e detyrueshme përfshin leksionet e shkruara nga pedagogu në kurset përkatëse, leksione që kanë qenë objekt i një vlerësimi paraprak për literaturën primare; Stafi akademik përgatiti dhe shënime për leksionet për secilën lëndë të përshtatura për studentët. Këto burime për mësimnxënien mund të aksesohen fizikisht në Bibliotekë ose të përdoren në Bibliotekën online për burime të ndryshme në anglisht. Biblioteka i shërben zhvillimit të procesit mësimdhënës-akademik nëpërmjet programeve të studimit të ofruara. Ka një rregullore të afishuar në ambientet e saj (Dëshmia 94 - Rregullat e Bibliotekës) bashku me orarin e përdorimit. Fondi i Bibliotekës pasurohet periodikisht nëpërmjet abonimeve në biblioteka dhe revistave online **(A96)**, blerjeve të financuara nga KPT-ja, donacioneve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me palët e treta. Falë marrëveshjes së bashkëpunimit me UET-në **(A97)**. **[Shtojca Nr. 1, Standardi V.7]**

5.8 KPT-ja është angazhuar për t'i mbështetur studentët gjatë tranzicionit të tyre drejt punësimit. Programet koherente të studimit me nevojat e tregut të punës, dijet dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve dhe stazhi e shtojnë vlerën e mbështetjes së KPT-së për punësimin e studentëve. KPT-ja ka partneritete të shumta me kompaninë private, që shërben si urë midis studentëve të KPT-së dhe punësimit. Mbikëqyrja e marrëveshjeve me partnerët menaxhohet nga çdo Njësi Bazë. Monitorimi i punësimit nga Zyra e Karrierës dhe e Ish-Studentëve dhe krijimi i një rrjeti ish-studentësh është gjithashtu jetike për KPT-në sepse lehtëson marrëdhëniet midis studentëve dhe bizneseve. Veç kësaj, në KPT, është Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, që përveç detyrave të tjera, në bashkëpunim me departamentet, punon për organizimin dhe vazhdimësinë e praktikave profesionale, si dhe për krijimin e urave të forta dhe lehtësimin e integritimit në tregun e punës për studentët si dhe për realizimin e këshillimit të duhur për karrierën. Detyrat funksionale të mësipërme dhe të tjera. Zyra e Karrierës mban dhe kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve, për të ndjekur ecurinë e punësimit të tyre për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende, si dhe për t'i ndihmuar të hyjnë dhe të përshtaten me tregun e punës. **(A20, A79)**. KPT-ja i publikon rregullisht Njoftimet e Punësimit në faqen e saj të internetit **(A80)** dhe organizon dhe vizita në terren në kompani. **[Shtojca Nr. 1, Standardi V.8]**

5.9 Zyra e Karrierës mban dhe kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve, për të ndjekur ecurinë e punësimit të tyre për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende, si dhe për t'i ndihmuar të hyjnë dhe të përshtaten me tregun e punës. Kontaktet me ish-studentët përdoren si vërejtje edhe për programet e studimit. **(A20, A79, BM6)** **[Shtojca Nr. 1, Standardi V.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Ekipi i Vlerësimit nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë.

Pikat e dobëta

Ekipi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Ekipi i Vlerësimit nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Ekipi i Vlerësimit nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

Lista A: Lista e evidencave

Lista e evidencave të mundësuar si pjesë e dokumenteve të vetëvlerësimit, shtojcë e RVV-së. Këto evidenca për RVJ-në referohen me shkurtesën A1, A2,..., etj:

- Shkresa shoqeruese.pdf
- Vetedeklarimi.pdf
- Raporti i Vetëvlerësimit (RVV).pdf
- Raporti i Vetëvlerësimit per Akreditimin Institucional.Pdf

Shtojcat në Anglisht

- 1 ORDER NO.5-1 DATE 28-03-2022 ENG.pdf
- 2 BYLAW ENG.pdf
- 3 DECISION OF THE COUNCIL OF MINISTERS NO 699,DATE 26-08-2015 ENG.pdf
- 4 KPT REGULATION ENG.pdf
- 5 DEVELOPMENT STRATEGY ENG.pdf
- 5-1 DEVELOPMENT STRATEGY 2015-2020 ENG.pdf
- 6 TIK STUDY PROGRAM REGULATION AS AN EXAMPLE ENG.pdf
- 7 REGULATION OF PROFESSIONAL PRACTICE ENG.pdf
- 8 DECISION ON THE ESTABLISHMENT OF IQAU ENG.pdf
- 9 PROJECTS OFFICE REGULATION ENG.pdf
- 10 LIST OF PROJECT ENG.pdf
- 11 CODE OF ETHICS ENG.pdf
- 12 INVITATION TO STAFF ENG.pdf
- 13 MINUTES OF MEETING _ DECISIONS OF THE RECTORATE AND DEPARTMENT ENG.pdf
- 14 IQAU REPORT ENG.pdf
- 14-1 CONTROLS OF THE DEPARTMENT ENG-ALB.pdf
- 15 RECTORATE ONLINE MEETING ENG.pdf
- 16 ANNUAL REPORT ALB.pdf
- 17 EQUIPMENT PURCHASE ENG.pdf
- 18 EXPERT'S OPINION ENG.pdf
- 19 CURRICULA REVIEW ENGINE ENG.pdf
- 20 STUDENTS EMPLOYMENT ENG-ALB.pdf
- 21 INFRASTRUCTURE KPT ENG.pdf
- 22 EVALUATION FORMS STUDENTS ENG.pdf
- 23 FOCUS GROUPS ENG.pdf
- 24 MENTORING-ACADEMIC COUNSELLING ENG.pdf
- 25 STAFF SURVEY ENG.pdf
- 26 ASSEMBLY MEETING ENG.pdf
- 27 USIA ROUNDTABLE ENG.pdf
- 28 IQAU REGULATION ENG.pdf
- 29 ORIENTATION WEEK ENG-ALB.pdf
- 30 NOTIFICATION ON THE COMPOSITION OF IQAU ENG.pdf
- 31 HR MANUAL ENG.pdf
- 32 STANDARD EMPLOYMENT AGREEMENT ENG.pdf
- 33 CALL FOR PUBLISHING,PUBLISHING LIST,PROMOTIONS ENG.pdf

34 CONNECTED THROUGH MOBILITY FILE ENG-ALB.pdf
35 STAFF ACTIVITIES IN THE FRAME OF PROJECTS, TRAININGS ENG-ALB.pdf
36 STAFF FILE ALB-ENG .pdf
37 STUDENTS' TRAINING ENGALB.pdf
38 USIA UNIT ENG.pdf
39 EU FOR INNOVATION ALBENG.pdf
40 EXTRACURRICULAR ACTIVITIES ALB.pdf
41 APPLIED RESEARCH ENG.pdf
42 OBLIGATIONS IN REAL TIME PAYMENTS OF CONTRIBUTIONS) ALB.pdf
43 STAFF LIST ALB.pdf
44 STATE MANAGEMENT POLICY ENG.pdf
45 LABORATORIES ENG.pdf
46 SENDING POLYTECH MANUALS ENG.pdf
47 AUDITING ISHP ISHTI ENG.pdf
48 ERASMUS DAYS 2021 ENG-ALB.pdf
49 ON SITE VISITS ALB.pdf
50 TOURS ENG-ALB.pdf
51 ORGANIZATION'S DOCTOR ENG.pdf
52 IT INFRASTRUCTURE ENG .pdf
53 KPT HUB ENG.pdf
54 INVENTORY, LIBRARY INVENTORY ENG.pdf
55 USIA AND ENGINE EQUIPMENT ENG.pdf
56 COMMUNICATION ON LABS' MANUALS ENG.pdf
57 HEI 'S LIST OF AGREEMENTS – AGREEMENTS ALBENG.pdf
58 VIEW OF THE PROTOCOL REGISTER ALB.pdf
59 INFORMATION SYSTEM CLASSTER ENG.pdf
60 CORE REGISTER ALB.pdf
61 REGISTER OF ACADEMIC ACHIEVEMENTS ALB.pdf
62 DIPLOMA REGISTER ALB.pdf
63 COMMUNICATION POLICY ENG.pdf
64 1 KPT WEB PAGE SCREEN SHOT ALB.pdf
65 ONLINE LEARNING – IT OFFICE VIDEO TUTORIAL MANUAL ENG.pdf
66 JM MODULE ENGALB.pdf
67 WORKSHOP ONLINE USIA MOVET ENG.pdf
68 COMMUNICATION MES, "ON THE INFORMATION OF THE GRADUATES", ALB.pdf
69 RECTORS CONFERENCE ACTIVITY ALB.pdf
70 MOU_UTH ENG.pdf
71 LIST OF AGREEMENTS WITH ORGANIZATIONS - AGREEMENTS ALBENG.pdf
72 USIAWP1 ENG.pdf
73 USIA WP5 ENG.pdf
74 MOVET DESIGN THINKING WORKSHOP ENG.pdf
75 OPENING OF A NEW STUDY PROGRAM FILE ENG.pdf
76 WORK AND STUDY FAIRS ENGALB.pdf
77 PARTICIPATION LABOR MARKET ROUND TABLE ALB.pdf
78 ENGINE INTERVIEW ENGALB.pdf
79 ALUMNI SURVEY ENG.pdf
80 EMPLOYMENT CALL FOR STUDENTS ENGALB.pdf
81 COMMUNICATIONS TO CA ENG.pdf
82 INVITATION TO BE PART IN PROJECTS ENG.pdf
83 SYLLABUS (EXAMPLE) ENG.pdf
84 ACADEMIC CALENDAR ENG.pdf

85 DECISIONS OF THE SENATE ENG.pdf
86 POLICY OF APPLIED RESEARCH IN KPT ENG.pdf
87 MENTORING REGULATION ENG.pdf
88 E MAILS FROM COORDINATORS ENG.pdf
89 OPEN DAYS AT KPT ENGALB.pdf
90 ACADEMIC PLAN ENG.pdf
91 SCREEN SHOT 360 TOUR ENGALB.pdf
92 ADDITIONAL HOURS FILE ENG.pdf
93 APPROVAL OF DIPLOMA TEMPLATE ALB.pdf
94 LIBRARY REGULATION ENG.pdf
95 HOUSE OF EUROPE FAIR ENG.pdf
96 ONLINE LIBRARY ENG.pdf
97 COLLABORATION AGREEMENT WITH UET ENGALB.pdf
98 LIST OF PUBLICATIONS – PROMOTIONS ENG.pdf
99 STUDENT’S MANUAL ENG.pdf
100 REQUEST FORM ENG.pdf
101 NASA HACKATHON COMPETITIONS) ENGALB.pdf
102 INTERNET POLICY ENG.pdf
103 STUDENTS’ COUNCIL ENGALB.pdf
104 SKS SURVEY ENGALB.pdf
105 BROCHURES MODELS THROUGH THE YEARS ALB.pdf
106 TRANSFER REGULATION AND REFERENCE CASE ENG.pdf
107 CONNECT IT ENGALB.pdf
108 MEETING WITH BUSINESS ANG.pdf
109 STUDENTS’ CARD ENGALB.pdf
110 VISUAL MEDIA ENGALB.pdf
111 INFORMATION ON WEB ENGALB.pdf
112 INTERNSHIP FILE ENG.pdf

Shtojcat në shqip

1 URDHRI NR. 5-1 DATE 28-03-2022.pdf
2 STATUTI KPT.pdf
3 VENDIMI I KESHILLIT TE MINISTRAVE NUMER 699, DATE 26-08-2015.pdf
4 RREGULLORJA KPT.pdf
5 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT.pdf
5-1 STRATEGJIA 2015-2020.pdf
6 RRREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT TIK.pdf
7 RREGULLORJA E PRAKTIKES PROFESIONALE.pdf
8 VENDIMI I NGRITJES SE NJSBC.pdf
9 RREGULLORJA E ZYRES SE PROJEKTEVE.pdf
10 LISTA E PROJEKTEVE.pdf
11 KODI ETIKES.pdf
12 FTESË PËR MENDIM STAFI.pdf
13 PROCESVERBALE TE MBLEDHJEVE VENDIMEVE REKTORAT DEPARTAMENT.pdf
14 RAPORTI NJSBC.pdf
14-1 KONTROLLE NGA DEPARTAMENTI.pdf
15 MBLEDHJE ONLINE REKTORAT.pdf
16 RAPORTI VJETOR.pdf
17 BLERJE OAJUSJE.pdf

18 MENDIMI I EKSPERTIT.pdf
19 RISHIKIM PROGRAMI (ENGINE).pdf
20 PUNESIMI I STUDENTEVE.pdf
21 INFRASTRUKTURA KPT.pdf
22 FORMULARET E VLERSIMIT STUDENTE.pdf
23 FOKUS GRUPE.pdf
24 TUTORIATE - KESHILLIM AKADEMIK.pdf
25 ANKETA STAFI.pdf
26 MBLEDHJE E ASAMBLESE.pdf
27 USIA ROUNDTABLE.pdf
28 RREGULLORJA NJSBC.pdf
29 JAVA E ORIENTIMIT.pdf
30 NJOFTIM I PERBERJES SE NJSBC.pdf
31 MANUALI I BURIMEVE NJEREZORE.pdf
32 KONTRATA TIP E PUNES.pdf
33 THIRJE PER BOTIM - LISTE BOTIMESH - PROMOVIME.pdf
34 PRAKTIKA CONNECTED THROUGH MOBILITY.pdf
35 VEPRIMTARI TE STAFIT NE KUADER TE PROJEKTEVE, TRAJNIMEVE.pdf
36 DOSJA E PERSONELIT.pdf
37 TRAJNIME STUDENTE.pdf
38 ZYRA USIA.pdf
39 EU FOR INNOVATION.pdf
40 AKTIVITETE EKSTRAKURRIKULARE.pdf
41 KERKIMI I APLIKUAR.pdf
42 DETYRIMET NE KOHE REALE-PAGESA KONTRIBUTESH.pdf
43 LISTA E STAFIT.pdf
44 POLITIKA E MANAXHIMIT TE PRONES.pdf
45 LABORTORET.pdf
46 DERGIMI I MANUALET POLYTECH.pdf
47 INSPEKTIMET ISHP-ISHTI.pdf
48 DITET ERASMUS.pdf
49 VIZITA NE TERREN.pdf
50 TURET.pdf
51 MJEKU NDERMARJES.pdf
52 INFRASTRUKTURA IT.pdf
53 KPT HUB.pdf
54 INVENTARI.pdf
55 PAISJE USIA-ENGINE.pdf
56 KOMUNIKIM PER MANUALET E LABORATOREVE.pdf
57 LISTA E MARREVESHJEVE ME IAL.pdf
58 PAMJE E REGJISTRIT TE PROTOKOLLIT.pdf
59 SISTEMI I INFORMACIONIT-CLASSTER.pdf
60 REGJISTRE BAZE.pdf
61 REGJISTRI I ARRITJEVE AKADEMIKE.pdf
62 REGJISTRI I DIPLOMAVE.pdf
63 POLITIKA E KOMUNIKIMIT.pdf
64 POLITIKA E MENAXHIMIT TE FAQES SE INTERNETIT.pdf
64-1 SCREEN SHOT I FAQES SE INTERNETIT.pdf
65 MESIMI ONLINE - ZYRA IT VIDIO TUTORIALE - MANUALE.pdf
66 MODULI JM ETJ..pdf
67 WORKSHOP ONLINE USIA-MOVET.pdf

68 SHKRESA MASR PER NJOHJEN DHE INFORMIMIN E MATURANTEVE.pdf
69 AKTIVITETI KONFERENCA E REKTOREVE.pdf
70 MOU-UTH.pdf
71 LISTA E MARREVESHJEVE ME SUBJEKTET PRITESE.pdf
72 USIA WP-1.pdf
73 USIA WP-5.pdf
74 MOVET, DESING THINKING WORKSHOP.pdf
75 HAPJA E PROGRAMIT TE RI.pdf
76 PANAIRET WORK & STUDY.pdf
77 PJESEMARRJE, TAVOLINE PER TREGUN E PUNES.pdf
78 ENGINE INTERVIEW.pdf
79 SONDAZHI ALUMNI.pdf
80 NJOFTIMI MBI MUNDESITE E PUNESIMIT.pdf
81 SHKRESA AK.pdf
82 FTESE PER TE QENE PJESE E PROJEKTEVE.pdf
83 MODEL SYLLABUS.pdf
84 KALENDARI AKADEMIK.pdf
85 VENDIME SENATI.pdf
86 POLITIKA E KERKIMIT TE APLIKUAR NE KPT.pdf
87 RREGULLORJA TUTORIATI.pdf
88 E-MAILET NJOFTUESE NGA KOORDINATORET.pdf
89 OPEN DAYS NE KPT.pdf
90 PLANET MESIMORE.pdf
91 SCREENSHOT E TUR360 GRADE.pdf
92 PRAKTIKA PER ORE SHTESE.pdf
93 MIRATIMI I MODELIT TE DIPLOMES.pdf
94 RREGULLORJA E BIBLIOTEKES.pdf
95 PANAIRI HOUSE OF EUROPE.pdf
96 BIBLIOTEKA ONLINE.pdf
97 MARREVESHJA E BASHKEPUNIMIT ME UET.pdf
98 LISTA E BOTIMEVE.pdf
99 MANUALI I STUDENTIT.pdf
100 FORMULAR KERKESE.pdf
101 NASA,HACKTHON,KONKURSE.pdf
102 POLITIKA E INTERNETIT.pdf
103 KESHILLI I STUDENTEVE.pdf
104 SKS (SONDAZHI KOMBETAR I STUDENTEVE).pdf
105 MODELE BROSHURAT NDER VITE.pdf
106 RREGULLORJA E TRANSFERIMIT, RAST PRAKTIK.pdf
107 CONNECT IT.pdf
108 TAKIME ME BIZNESE.pdf
109 KARTA E STUDENTIT.pdf
110 MEDIA VIZIVE.pdf
111 INFORMACION NE WEB.pdf
112 DOSJA E PRAKTIKES.pdf

Lista B: Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës

Mbledhjet janë referuar në raport duke përdorur shkurtimet BM1, BM2, etj.

BM1: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional

BM2: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Rektorin.
BM3: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup studentësh.
BM4: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup të stafit akademik.
BM5: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon një grup të stafit mbështetës/administrativ.
BM6: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon partnerët e jashtëm dhe ish-studentë.
BM7: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional
BM8: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon drejtuesit e lartë
BM9: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
BM10: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Grupin e Vetëvlerësimit.
BM11: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Rektorin për të përmbledhur pikat kryesore me interes dhe çështjet shoqëruese të trajtuara gjatë vlerësimit.
Tur në mjedise.

Lista C: Lista e evidencave të paraqitura gjatë vizitës

Lista e evidencave të paraqitura gjatë vizitës në ambient. Këto evidenca për RVJ-në referohen me shkurtesën C1, C2..., etj:

1. Evidenca shtesë Plani i Punës NJSBC.pdf
2. Evidence Shtesë Implementimi i Action Plan.pdf